



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr Prot
Dip.	Br prot
Dep.	Prot No
Nr. Tituj	Data
Broj stranica	Datum
Nr. pages	Date
02	01-390/16
	01-02-2016



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 28.01.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3429/15, për zyrtarin e lartë z. Hajdar Loku, Këshilltar Komunal në Komunën e Kaçanikut, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-3429/15, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Hajdar Loku, Këshilltar Komunal në Komunën e Kaçanikut.

Gjatë procesit për identifikimin e rasteve të dyshuara për konfliktit të mundshëm të interesit, është identifikuar rasti për zyrtarin e lartë z. Hajdar Loku, Këshilltar Komunal në Komunën e Kaçanikut.

Është vërejtur se zyrtari i lartë ka të regjistruar një biznes privatë dhe figuron si person i autorizuar në dy biznese private e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin të funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 27.10.2015 e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Hajdar Loku ka ardhur ne zyrat e AKK-së dhe nga zyrtarët të ngarkuar me rastin është njoftuar për situatën në të cilën gjendet si dhe me faktet dhe provat qe disponon AKK-ja.

Gjatë takimi me zyrtarin e lartë është pajtuar me gjendjen dhe është zotuar se do të mundohet që brenda afatit ligjor do të sjell dëshmitë qe është shmangur nga situata e mundshme e konfliktit të interesit .

Ne ndërkohë z. Hajdar Loku ka sjell dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se z. Hajdar Loku ka hequr dore nga e drejta e ushtrimit të funksionit të personit të autorizuar tek biznesi më emër N.T.SH “AGRO” me numër 71050912, ndërsa na ka njoftuar se tek biznesi “ELITE” SH.P.K. ku është si person i autorizuar e ka të pa mundur ti bej ndryshimet pasi qe pronari i këtij biznesi gjendet jashtë vendit por do të bej përpjekje qe të kontaktoj me të dhe të kërkoj nga aj qe ta liroj na ky funksion.

Agjencia kundër Korrupsionit duke parë qe zyrtari nuk ka sjell dokumentet dhe çështja po zvarritet i ka ber edhe shkresën e dytë dhe i kemi dhen afat sipas Ligjit Nr.04/L-051.

Në ndërkohë kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se ne biznesin me emër“ ELITE” SH.P.K. me numër 71169936 z. Hajdar Loku nuk figuron me si person i autorizuar i këtij biznesi.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Hajdar Loku, Këshilltar Komunal në Komunën e Kaçanikut duke ber ndryshimet në biznesin privat dhe duke u larguar nga personi i autorizuar ne bizneset e lartë cekura janë krijuar rrethana të reja dhe konstatojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

